

Orig.English / vers. Albanian
Unofficial, unrevised translation



COUNCIL OF EUROPE CONSEIL DE L'EUROPE

Seria e Traktateve Evropiane - Nr. 154

**PROTOKOLL
I KONVENTËS EVROPIANE
TË SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Strasburg, 11.V.1994

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij Protokollit të Konventës Evropiane të Sigurimeve Shoqërore, nënshkruar në Paris më 14 Dhjetor 1972 (e përmendur më poshtë si “Konventa”),

Duke vërejtur se është e nevojshme të amendohen disa dispozita të Konventës me qëllim që të zgjerohet fusha e zbatimit të saj,

Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

- 1 Në marrëdhëniet ndërmjet Palëve Kontraktuese të Konventës të angazhuara në këtë Protokoll, dispozitat e paraqitura në Nenin 2 në vijim zëvendësojnë dispozitat përgjegjëse të Konventës.
- 2 Në marrëdhëniet ndërmjet Palëve Kontraktuese të Konventës që nuk janë Palë e këtij Protokollit dhe Palëve të këtij Protokollit, Konventa mbetet e zbatueshme në formën e saj fillestare.

Neni 2

Neni 4 i Konventës duhet lexuar si vijon:

- “1 Dispozitat e kësaj Konvente do të zbatohen:

a ndaj të gjithë personave që janë, apo kanë qenë, objekt i legjislacionit të njëjës apo të shumë prej Palëve Kontraktuese, si dhe ndaj anëtarëve të familjeve të tyre dhe trashëgimtarëve të tyre ;

b pa shkelur Nenin 2, paragrafi 4, ndaj nëpunësve civilë dhe personave të trajtuar si të tillë nga legjislacioni i Palëve Kontraktuese, për sa kohë që janë objekt i legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese ndaj të cilës zbatohet kjo Konventë.

- 2 Pavarësisht nga dispozitat e nën-paragrafit b të paragrafit paraprirës, kategoritë e personave – përveç anëtarëve të personelit të misioneve diplomatike apo posteve konsullore dhe personave të punësuar në shërbimin privat të zyrtarëve të misioneve apo posteve të tilla – për të cilët Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike dhe Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore parashikojnë përjashtimin nga dispozitat e sigurimeve shoqërore në fuqi në Shtetin pritës, nuk do të përfitojnë nga dispozitat e kësaj Konvente.”

Neni 3

- 1 Çdo Shtet anëtar i Këshillit të Evropës mundet, në kohën e nënshkrimit të këtij Protokollit apo në datën e ratifikimit, pranimit apo miratimit të tij, të deklarojë zbatimin e Nenit 8 apo Nenit 11 apo të të dyja neneve të Konventës vetëm ndaj personave që mbulohen nga Neni 4 i Konventës pa marrë parasysh amendamentet e parashikuara në Nenin 2 të këtij Protokollit.
- 2 Çdo Palë që është mbështetur në deklaratën e parashikuar në paragrafin e mëparshëm ka mundësi të heqë dorë nga një deklaratë e tillë në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 4

Dispozitat e Nenit 74 të Konventës do të zbatohen, *mutatis mutandis*, në rastin e këtij Protokollit.

Neni 5

- 1 Ky Protokoll do jetë i hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës nënshkruese të Konventës, të cilat mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u angazhuar nëpërmjet:

- a nënshkrimin pa rezervë të ratifikimit, pranimit a miratimit; apo
- b nënshkrimin të subjektit të ratifikimit, pranimit apo miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi apo miratimi.
- 2 Instrumentat e ratifikimit, pranimit apo miratimit duhet të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.
- 3 Një Shtet anëtar i Këshillit të Evropës mund të mos nënshkruajë pa rezerva ratifikimin, pranimin apo miratimin, ose mund të mos i depozitojë instrumentat e tij të ratifikimit, pranimit apo aprovimit nëse s'është ende apo nëse s'është duke u bërë njëkohësisht Palë Kontraktuese e Konventës.

Neni 6

- 1 Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe tremujore nga data në të cilën dy Shtete anëtare kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u angazhuar me këtë Protokoll në përputhje me dispozitat e Nenit 5.
- 2 Përsa i përket çdo Shteti anëtar që më pas jep pëlqimin e tij të angazhohet me të, ky Protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe tremujore nga data e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 7

- 1 Çdo Shtet jo anëtar i Këshillit të Evropës që aderon në Konventë me ftesë të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në përputhje me Nenin 77 të saj, mund të aderojë në këtë Protokoll.
- 2 Aderimi do të kryhet duke depozituar tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës një instrument aderimi i cili bëhet i efektshëm në datën e aderimit në Konventë apo, në rastin e një aderimi të mëvonshëm, ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe tremujore nga data e depozitimit të tij.

Neni 8

- 1 Ky protokoll do të ketë një kohëzgjatje të njëjtë me Konventën.
- 2 Secila Palë, kur është e prekur, mund ta denoncojë këtë Protokoll pasi ai të ketë qenë në fuqi për një vit në lidhje me këtë Palë, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
- 3 Ky denoncim bëhet i efektshëm gjashtë muaj pas datës së marrjes nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të këtij njoftimi.
- 4 Dispozitat e Nenit 79 të Konventës do të zbatohen, *mutatis mutandis*, në rastin e këtij protokoll.

Neni 9

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, brenda një muaji duhet të njoftojë Palët, Shtetet nënshkruese dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për:

- a çdo nënshkrim;
- b çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi apo miratimi;
- c çdo deklaratë apo njoftim sipas dispozitave të Nenit 3;

- d çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokoll sipas Nenit 6;
- e çdo njoftim për denoncim marrë sipas dispozitave të Nenit 8;
- f çdo akt tjetër, njoftim apo komunikim që lidhet me këtë Protokoll.

Për të dëshmuar këtë, i nënshkruari, i autorizuar rregullisht, e nënshkruan këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg, më 11 maj 1994, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet janë njëlloj të vërtetë, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopjet e vërtetuara secilit prej Shteteve nënshkruese dhe atyre që pritet të aderojnë.